



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
DREJTORIA E MIGRACIONIT, DIASPORËS DHE E ÇESHTJEVE SOCIALE
SEKTORI I ÇESHTJEVE SOCIALE

Nr 133 Prot

Fushë-Arrëz, më 16.01.2026

PROJEKT-VENDIM

No3 Datë 16/01 / 2026

“Përcaktimin e kriterëve për dhënien e Ndhimes Ekonomike për familjet aplikuese të cilat nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen, nëpërmjet përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për Ndhimen Ekonomike dhe dhënien e Ndhimes Ekonomike për familjet në nevojë”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, të nenit 7, të ligjit nr. 57/2019, datë 18.07.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të Kreut IV, pika 2 të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të ndihmës ekonomike”, të ndryshuar, dhe Vendimit nr. 5, datë 23.02.2018, “Mbi miratimin e kriterëve për familjet në nevojë”, me përjashtim të pikave 1, 6 dhe 7 që do të trajtohen me ndihmën ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike. Sektori i Çështjeve Sociale, i propozon Këshillit të Bashkisë Fushë-Arrëz P/Vendimin për kriteret e 6% si më poshtë:

PROPOZON

1. Të gjitha familjet, të cilat kanë aplikuar nëpërmjet regjistrit elektronik për ndihmen ekonomike dhe nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit.
2. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale, (të veja, të divorcuara).
3. Familje me shumë fëmijë.
4. Familje me fëmijë jetim.
5. Familje me kushte të vështira ekonomike që në përbërjen e tyre kanë dy ose më shumë fëmijë që vazhdojnë studimet jashtë vendbanimit.
6. Familje të cilat nuk kanë asnjë të punësuar.
7. Familje me anëtarë me sëmundje kronike.
8. Familjeve një herë në tre muaj t'u bëhen riaplikim në skemën e NE.
9. Përfituesit nga çdo lloj kriteri, të masës së ndihmes ekonomike prej 6%, duhet të jetë banues fizikisht në Bashkinë Fushë-Arrëz.
10. Familje me kushte të vështira ekonomike që në përbërjen e tyre kanë anëtarë me aftësi të kufizuara apo invalid pune.
11. Persona që jetojnë vetëm, të moshuar dhe të rinj me probleme sociale.
12. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me aftësi të kufizuar, sëmundje të rënda, të cilët nuk përfitojnë nga KMCAJ-ja dhe janë në kushtë të vështira socio-ekonomike.

Përgjegjëse e Çeshtjeve Sociale

Klotilda Curri

K R Y E T A R I

Hil CURRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
DREJTORIA E MIGRACIONIT, DIASPORËS DHE E ÇESHTJEVE SOCIALE
SEKTORI I ÇESHTJEVE SOCIALE

Nr 133 Prot

Fushë-Arrëz, më 16.01.2026

RELACION

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore", të nenit 7, të ligjit nr. 57/2019, datë 18.07.2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të Kreut IV, pika 2 të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të ndihmës ekonomike", të ndryshuar, dhe Vendimit nr. 5, datë 23.02.2018, "Mbi miratimin e kriterëve për familjet në nevojë", me përjashtim të pikave 1, 6 dhe 7 që do të trajtohen me ndihmën ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike.

Në bazë të nevojave që ka Bashkia Fushë-Arrëz dhe në përputhje me ligjin, Sektori i Çeshtjeve Sociale ka paraqitur pranë Këshillit Bashkiak kriteret specifike të fondit 6% për vitin 2026, për familjet që shpallen jo fituese sipas sistemit të pikëzimit.

Përgjegjëse e Çeshtjeve Sociale

Klotilda Curri

KRYETARI

HI CURRI



3